**Ligjerata 1**

# Hyrje në *Kontabilitetin Menaxherial* dhe mjedisi biznesor

KONTABILITETI MENAXHERIAL

© 2014 Ylber Prekazi

## Definimi i Kontabilitetit Menaxherial

**Kontabiliteti menaxherial është** proces i

- ✓ Identifikimit
- ✓ Matjes
- ✓ Grumbullimit
- ✓ Analizës
- ✓ Përgaditjes
- ✓ Interpretimit
- ✓ Komunikimit të informacionit

# Modeli i funksionimit të sistemit të informacionit të kontabilitetit menaxherial






# PSE NE KEMI NJË SISTEM TË KONTABILITETIT?

- Sistemet e kontabilitetit janë mjeshtri në vete. Ato janë krijuar për t'i ndihmuar njeriut për përmbushjen e qëllimeve
- Raportet e audituara zvogëlojnë rrezikun
- Raportet e audituara i lejojnë kompanisë të huazoj kapital nga dikush tjetër
- Regjistrimet dhe kontrolli financiar i brendshëm siguron asetet e kompanisë
- Bilanci i gjendjes lejon krahasimin e aseteve, detyrimeve dhe ekuitetit të pronarëve
- Pasqyra e të ardhurave përshkruan ndryshimet në ekuitetin e pronarëve nga operacionet e kryera, etj.

# Sistemi i Kontabilitetit Menaxherial
## ka tre objektiva të mëdha:

1) Të sigurojë informacionin për koston e produkteve (apo shërbimeve)

2) Të sigurojë informacionin për planifikimin, kontrollin dhe vlerësimin e performancës

3) Të sigurojë informacionin për marrjen e vendimeve



## ...FUNKSIONET E MENAXHMENTIT




PLANIFIKIMI DHE CIKLI I KONTROLLIT
Formulimi i planeve afatshkurtëra dhe afatgjata
(PLANIFIKIMI)
Fillimi…
Implementimi i planeve
(DREJTIMI DHE MOTIVIMI)
Vendim marrja
Krahasimi i performancave aktuale me ato të arriturat
(KONTROLLIMI)
Matja e performancave
(KONTROLLIMI)


Menaxhimi i Burimeve, Aktiviteteve, dhe Njerzëve
Në organizatë (firmë). . .
Drejtimi
Burimet
Organizimi i aktiviteteve
Marrja e vendimeve
Njerëzit
Kontrolli
Planifikimi
1-8

## SI E SHTON VLERËN E ORGANIZATËS KONTABILITETI MENAXHERIAL?

- Duke ofruar informata për vendimmarrje dhe planifikim
- Asistimi për menaxherët në drejtimin dhe kontrollimin e aktiviteteve
- Motivimi i menaxherëve dhe të punësuarve të tjerëve drejt qëllimeve të kompanisë
- Matja e performancave të aktiviteteve, menaxherëve dhe të punësuarve tjerë
- Përcaktimi i pozitës konkurruese të organizatës

## KONTABILITETI MENAXHERIAL & KONTABILITETI FINANCIAR

***KONTABILITETI FINANCIAR*** është procesi i përgatitjes, raportimit dhe interpretimit të informacionit kontabël që u ofrohet marrësve të jashtëm për vendim marrje

***KONTABILITETI MENAXHERIAL*** është proces i përgatitjes, raportimit dhe interpretimit të informacionit llogaritar që u jepet marrësve të brendshëm të informatave për vendim marrje





## RAPORTI I KONTABILITETIT MENAXHERIAL DHE KONTABILITETIT FINANCIAR

**SISTEMI I KONTABILITETIT**
**(akumulimi i të dhënave financiare dhe i MENAXHMENTIT)**

**KONTABILITETI I MENAXHMENTIT**
**Informacioni për marrjen e vendimeve dhe kontrollin e operacioneve të ndërmarrjes**



**Shfrytëzuesit e brendshëm**

**KONTABILITETI FINANCIAR**
**Publikimi i pasqyrave financiare dhe raporteve tjera financiare**



**Shfrytëzuesit e jashtëm**

## SHFRYTËZUESIT E INFORMATAVE TË KONTABILITETIT

**Kontabiliteti MENAXHERIAL është i drejtuar kah shfrytëzuesit e brendshëm**



- ✓ Menaxherët
- ✓ Zyrtarët
- ✓ Auditorët e brendshëm
- ✓ Stafi
- ✓ Zyrtarë të buxhetit
- ✓ Kontrollorët

**Kontabiliteti FINANCIAR është i drejtuar kah shfrytëzuesit e jashtëm**



- ✓ Kreditorët
- ✓ Aksionarët
- ✓ Qeveria
- ✓ Sindikatat
- ✓ Auditorët e jashtëm
- ✓ Konsumatorët

# Kontabiliteti Menaxherial kundrejt Kontabilitetit Financiar

| | Kontabiliteti Financiar | Kontabiliteti Menaxherial |
|---|---|---|
| **PËRDORUESIT KRYESORË TË INFORMACIONIT** | Personat dhe organizatat jashtë njësisë së biznesit | Nivele të ndryshme të menaxhimit të brendshëm |
| **LLOJET E SISTEMEVE KONTABËL** | Sistemet e regjistrimit të dyfishtë | Jo i kufizuar nga sistemi i regjistrimit të dyfishtë. Çdo sistem që është i dobishëm |
| **RREGULLAT E VEPRIMIT** | Respektimi i parimeve të përgjithshme të pranuara të kontabilitetit | Nuk ka udhëzime ose kushtëzime. I vetmi kriter është dobishmëria |
| **NJËSIA E MATJES** | Njësia monetare (vlera historike) | Çdo njësi monetare ose fizike që është e dobishme: orët e punës së punëtorit, orët e punës së makinerisë, etj. Në rast të përdorimit të vlerës monetare-mund të jetë historike ose e ardhshme |
| **KËNDVËSHTRIMI PËR ANALIZË** | Njësia e biznesit si një e tërë | Segmente të ndryshme të njësisë së biznesit |
| **SHPESHTËSIA E RAPORTIMIT** | Në mënyrë të rregullt, periodikisht | Kur është e nevojshme, bile jo në mënyrë të rregullt |
| **SHKALLA E BESUESHMËRISË** | Kërkohet objektivitet, është historik nga pikëpamja e natyrës | Mjaft subjektiv për qëllimet e planifikimit, por kur është e nevojshme përdoren edhe të dhënat objektive; nga pikëpamja e natyrës është me drejtim nga e ardhmja |



# Kontabiliteti dhe Etika Profesionale



- Përgjegjshmëria
- Konfidencialiteti
- Shmangia
- Integriteti
- Objektiviteti

## KODI I ETIKËS PËR KONTABILISTËT MENAXHERIAL



**PËRGJEGJSHMËRIA**

- Përcjellja e ligjeve aplikative, rregulloreve dhe standardeve
- Ruajtja e kompetencës profesionale
- Përgatitja komplete dhe e qartë e raporteve pas analizave të duhura



## ...KODI I ETIKËS PËR KONTABILISTËT MENAXHERIAL



**KONFIDENCIALITETI**

- Të mos zbuloj informata konfidenciale derisa legalisht të mos obligohet
- Të mos shfrytëzohen informatat konfidenciale për avantazhe personale
- Të sigurohet se vartësia nuk i zbulon informatat

## ...KODI I ETIKËS PËR KONTABILISTËT MENAXHERIAL



**Shmangia...**

- Shmangia nga konflikti i interesave dhe konsultimi i të tjerëve në konflikt potencial
- Të mos shkatërroj objektivat legjitime të kompanisë
- Njohja dhe komunikimi i kufizimeve personale dhe profesionale



## ...KODI I ETIKËS PËR KONTABILISTËT MENAXHERIAL



**INTEGRITETI**

- Shmangia e aktiviteteve që mund ndikojnë në përmbushjen e detyrave
- Përmbajta ndaj aktiviteteve që mund të diskreditojnë profesionin
- Refuzimi i dhuratave në favor të ndikimit të mundshëm
- Komunikimi i informatave jo të favorshme si dhe atyre të favorshme

## ...KODI I ETIKËS PËR KONTABILISTËT MENAXHERIAL

Komunikimi i informatave të drejta dhe objektive

**OBJEKTIVITETI**

Paraqitja e të gjitha informatave që mund të jenë të dobishme për menaxhmentin

